



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM
“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 7 LICENCAVE TË TRANSMETIMIT
AUDIO ANALOGE PRIVATE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar, si dhe vendimmarrjes së autoritetit rregullator “Për çeljen e garës për dhënie të 7 licencave të transmetimit audio analoge private” do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 7 licencave private të transmetimit audio analoge, të përbërë nga

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarqet Tiranë dhe Durrës	Audio analoge Rajonale	Fushë Dajç	98,2
			Krujë	90,9
2.	Qarqet Tiranë dhe Durrës	Audio analoge Rajonale	Fushë Dajç	89
			Krujë	93,8
3.	Qarku Vlorë	Audio Analoge Lokale	Zvërnec	91,6
			Treblevë	92,5
			Himarë	88
			Llogora	95,3
			Mile	94,5
	Qarku Vlorë	Audio Analoge Lokale	Zvërnec	89,4
			Treblevë	96,3
			Himarë	89,8
			Llogora	97,1
			Mile	90,9

5.	Qarku Lezhë, Shkodër dhe Kukës	Audio Analoge Rajonale	Tyrbe Lezhë	92,5
			Rrëshen	93,1
			Tarabosh	92,2
			Maje e Rabes	90,6
			Mide	87,9
			Mide	87,9
			Kukës	88,2
			Qafë Prush	88,5
			Bajram Curri	90,3
6.	Qarqet Fier dhe Vlorë	Audio Analoge Rajonale	Ligovun	94,7
			Ballsh	96,2
			Vain	106,8
			Zvërnec	92,2
			Trebllovë	90,8
			Himarë	88
			Llogora	90,2
			Mile	104,3
7.	Bashkitë Korcë, Devoll	Audio Analoge Lokale	Çardhak	91,1

Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë private të transmetimit audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, ***brenda datës 17.07.2018 ora 10.00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio" e ndryshuar;
- Kushtet teknike të instalimit të pajisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit);
- Kërkesat programore;
- Pagesat për licencën, taksat etj, të llogaritura për zonën në fjalë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datën 17.07.2018, ora 10.00, në mjediset e AMA-s,*** ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.